



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 268142; Fax 04 268141

Nr. 400/6 Prot

Tiranë, më 24.11. 2015

V E N D I M

Nr. 125, datë 24/11/2015

Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit tematik, në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit dhe vlerësimin e rezultateve të punës, në Bashkinë Orikum, aktualisht Njësi Administrative e Bashkisë Vlorë

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 14, gërma "b", 32 e 33 të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit" miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (më poshtë rregullores), si dhe neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe mendimit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me inspektimin e zhvilluar në Bashkinë Orikum,

Vërej se:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe në përgjigje të kërkesës për bashkëpunim të Kryetarit të Bashkisë Orikum, me nr. 829 prot., datë 18.05.2015, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Vendimin nr. 53, datë 28.05.2015, "Për kryerjen e inspektimit tematik në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit dhe vlerësimin e rezultateve të punës për nëpunësit civilë në institucionin, Bashkia Orikum", ka urdhëruar kryerjen e inspektimit tematik në këtë institucion.

Në zbatim të këtij vendimi, me aktin nr. 400/2, datë 28.05.2015, "Njoftim për fillimin e inspektimit tematik", u njoftua institucioni, në lidhje me fillimin e inspektimit dhe objektin e tij.

Në përfundim të inspektimit, në përmbajtje të të cilit u trajtuan procesi i deklarimit të statusit të punësimit dhe vlerësimi i rezultateve të punës për nëpunësit civilë, grupi i inspektimit ka hartuar projekt raportin, i cili i është dërguar për njohje Bashkisë Vlorë, me shkresën nr. 400/4, datë

14.08.2015 “Dërgohet projekt raporti i inspektimit tematik në institucionin e Bashkisë Orikum”, duke i lënë 15 ditë kohë për të paraqitur observacionet në lidhje me materialin. Pas kësaj, me kërkesë të Bashkisë Vlorë, projekt raporti është ridërguar në datën 01.10.2015.

Në vijim të procesit dhe në përfundim të afatit që i është lënë institucionit për t’u shprehur në lidhje me pretendimet dhe observacionet për projektraportin, rezulton se me shkresën nr. 50207, datë 11.11.2015, nga ana e Bashkisë Vlorë është kthyer materiali i nënshkruar, pa vërejtje apo kundërshtime në lidhje me gjetjet dhe përfundimet e arritura prej grupit të inspektimit.

Në këto rrethana, Komisioneri e vlerëson si të përmbushur detyrimin për të njohur subjektin me gjetjet e grupit të inspektimit dhe çmon se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij, në lidhje me problematikën e evidentuar.

Për këtë arsye, procesi i inspektimit do të vijojë me dërgimin e raportit përfundimtar dhe të vendimit përkatës për miratimin e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të inspektimit tematik në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit dhe vlerësimin e rezultateve të punës në Bashkinë Orikum, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Njësia përgjegjëse në zbatim të nenit 115 të Kodit të Procedurave Administrative duhet të kryejë veprimet e mëposhtme administrative, duke nxjerrë aktet përkatëse:
 - a. Të revokohet akti nr. 25 prot., datë 24.03.2014, i deklarimit të statusit të nëpunësit civil në periudhë prove për punonjësen ***** , në pozicionin e punës “Drejtor Drejtorie” dhe t’i deklarohet statusi i punësimit “nëpunës civil”, i konfirmuar në pozicionin “Shef i Sektorit të Tatimeve”.
 - b. Të revokohet akti nr. 24 prot., datë 24.03.2014, i deklarimit të statusit të punësimit, për punonjësen ***** , në pozicionin “Shefe në Sektorin e Tatim Taksave në Drejtorinë e Menaxhimit të Financave Publike”, duke i konfirmuar statusin për pozicionin “Inspektore e tatim-taksave”.
 - c. Të bëhet deklarimi i statusit të punësimit si nëpunës civil i konfirmuar, për punonjësin ***** , në pozicionin që mban aktualisht, “Inspektor i Kontrollit dhe Vlerësimit Tatimor”, duke e ndërprerë periudhën e provës.

- d. Të ndërpritet periudha e provës dhe të bëhet deklarimi i statusit të punësimit si nëpunës civil i konfirmuar, për punonjësin ***** , në pozicionin që mban aktualisht, “*Kryeinspektor në Drejtorinë e Kontrollit të Territorit*”.
3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.
4. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Vlorë, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të inspektimit dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA